

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 pika 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027, nenin 67 "g" të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës me datën 11.01.2021 merr këtë:

VENDIM
PËR NGRITJE TË GATISHMËRISË EMERGJENTE

1. Ngritet gatishmëria emergjente dhe aktivizohet Qendra Lokale Emergjente në Komunën e Vushtrrisë për shkak të rrezikut të vërshimeve në disa fshatra, pas reshjeve të ditëve të fundit në Komunën e Vushtrrisë dhe jashtë saj.
2. Pika kritike të cilat janë rrezikuar nga vërshimet për shkak të prurjeve të ujit nga lumi Llap dhe Drenica në lumin Sitnica janë fshatrat: Pestovë, Prelluzhë Lumadh, Nadakoc dhe një pjesë e qytetit.
3. Të kontaktohen Kryetarët e Këshillave të fshatrave të cekura në pikën paraprahe, që të jenë vigjilent dhe përcjellin situatën në terren dhe të koordinojnë veprimet me komunitetin dhe institucionet e komunës për ndërmarrje të masave të duhura për tejkalim me sa më pak pasoja të gjendjes të krijuar nga vërshimet.
4. Ekonomive familjare, bizneseve etj. të cilat i ekspozohen rrezikut nga vërshimet të marrin masa për evakuim të familjarëve si dhe të mirave materiale dhe vendosje të tyre në vende të sigurta.
5. Palestra në fsh. Samadrexhë si dhe shkollat në qytet apo fshatra të rrezikuara nga vërshimet do të jenë vende të destinuara për strehim deri në kalim të situatës dhe kthimit të normalitetit në vendbanimet e vërshuara.
6. Njësia e Zjarrfikësve dhe QKMF në bashkëpunim dhe koordinim me Policinë të jenë në gjendje mobile për intervenim, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit dhe të mirave materiale.
7. Nga qytetarët kërkohet bashkëpunim në këtë situatë emergjente nga kjo fatkeqësi natyrore.
8. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.
9. Vendimi të shpalllet në mjetet elektronike të informimit publik të komunës.



Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITR	
02 Nr. / Br	10/21
Nr. i fq. / Br. sf	
Data: / Datum	11.01.2021
VUSHTRRI - VUČITR	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 pika 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027, nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIM TË SHTABIT PËR GATISHMËRI EMERGJENTE NË KOMUNËN E VUSHTRRISE

- Me qëllim të ndërmarrjes së masave për tejkalim të gjendjes së krijuar në terren nga vërshimet në disa vendbanime në territorin e komunës, formohet Shtabi për Gatishmëri Emergjente në këtë përbërje:
 - 1.1 Xhafer Tahiri**, Kryetar i Komunës, kryesues i shtabit
 - 1.2 Besim Muzaqi**, Nënkryetar i Komunës, anëtar
 - 1.3 Bajrush Kosumi**, Drejtor i DMSH-së, anëtar,
 - 1.4 Afrim Namani**, DKA, anëtar,
 - 1.5 Agron Përquku**, anëtar
 - 1.6 Refik Maloku**, DSHP, anëtar,
 - 1.7 Luljeta Zahiti**, Drejtoresh e QKMF-së, anëtare
 - 1.8 Reshat Kovaçi**, PK, anëtar
 - 1.9 Kumrije Zhabari**, Kryqi i Kuq, anëtare,
- Qendra Emergjente (Shtabi emergjent) do të përcjellë situatën në terren dhe koordinoj punët dhe veprimet e tij përmes zyrës komunale për lajmërim, të bashkëpunoj me Policinë e Kosovës, akter tjerë të ndërlidhur në këto situata emergjente.
- Zyra për informim të komunës të përcjell situatën në terren dhe sipas nevojës informoj me kohë qytetarët lidhur me gjendjen në terren për të përballuar sa më lehtë dhe pa pasoja situatat emergjente.
- Vendimi hyn në fuqi menjëherë.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Në pajtim me nenin 17 pika "g" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 pika 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027, Shtabi për gatishmëri emergjente i komunës në mbledhjen e mbajtur më 12.01.2021, pas vlerësimit të situatës nga pasojat e vërshimeve në Komunën e Vushtrrisë, merr këtë:


V E N D I M

1. Ekipet që veprojnë në terren të ndërmarrin masa të menjëhershme për evakuim dhe strehim të popullatës në ato raste kur jeta e tyre rrezikohet nga vërshimet në shtëpitë përkatësisht pronat e tyre. Gjithashtu të merren masa për largim të bagëtive e në raste të mundshme edhe të pajisjeve dhe makinerisë.
2. Drejtoria e emergjencës në bashkëpunim me akterët tjerë të involvuar në mbrojtjen nga vërshimet (KFOR-i, Kryqi i Kuq, njësitë e vullnetarëve etj.) të marrin masa për furnizim me ujë të pijes bazuar në kërkesat dhe nevojat ndaj familjeve të rrezikuara nga vërshimet.
3. Vendstrehime të mundshme për popullatën e evakuar caktohen: Salla e sporteve në Samadrexhë si dhe shkollat në qytet të cilat ofrojnë kushte më të përshtatshme për vendosje të familjeve të evakuara.
4. Qendra emergjente komunale në bashkëpunim me shtabin emergjent të përcjellin në vazhdimësi situatën në terren dhe marrin masa konform situatave dhe nevojave për intervenim deri në tejkalim të gjendjes emergjente dhe kthimit të normalitetit.
5. Shtabi emergjent do të jetë i angazhuar 24 orë në ditë deri në një vendim tjetër në bazë të të cilit shpallet e përfunduar gjendja emergjente.
6. Vendimi hyn në fuqi në menjëherë.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës –
Kryesues i Shtabit Emergjent



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 44 pika 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027, nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të komunës, si dhe për shkak të situatës rëndë të krijuar si pasojë e daljes nga shtrati i lumit Silnicë në territorin e komunës së Vushtrrisë dhe vërshimit të mbi 500 hektarë të tokave dhe vendbanimeve përgjatë këtij lumi, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIM TË KOMISIONIT PËR PËRGATITJE TË PARAMASËS DHE PARALLOGARISË
PËR NDËRTIM TË ARGJINATURAVE TË LUMIT SILNICA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË
VUSHTRRISË


1. Themelohet Komisioni për përgatitje të paramasës dhe parallogarisë për ndërtim të argjinaturave të lumit Silnica në territorin e komunës së Vushtrrisë, në këtë përbërje:
 - 1.1 **Mexhit Perçuku**, kryesues i komisionit
 - 1.2 **Nexhat Merovci**, anëtar
 - 1.3 **Isa Latifi**, anëtar
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi ka për detyrë që të dal në teren për të identifikuar vendet në të cilat janë dëmtuar argjinaturat ku për pasojë janë vërshuar sipërfaqe të konsiderueshme të tokave bujqësore si dhe lagje të fshatrave në të dy anët e këtij lumi si dhe lagje në qytetin e Vushtrrisë. Ky komision gjithashtu do të vlerësoj edhe pjesët tjera të lumit Silnicë në territorin e Komunës (në të cilat nuk ka argjinatura) sa metër gjatësi duhet ndërtuar argjinaturat.
3. Pas vlerësimit të detajuar profesional duhet të hartoj paramasë dhe parallogari me kosto financiare për vlerën e investimit në këtë projekt dhe dorëzoj te Kryetari i Komunës.
4. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të Sekretarisë



Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 8 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në propozimin e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim dt.15.01.2021, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE NGA VËRSHIMET

1. Themelohet Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve nga vërshimeve e datës 11, 12 dhe 13.01.2021 në Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:
 - 1.1 **Tefik Maloku**, kryesues i komisionit - DEBPZHR
 - 1.2 **Ramiz Maliqi**, anëtar - DUMM
 - 1.3 **Safet Veseli**, anëtar, anëtar - DGJKP
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi, detyrat e tija do të i kryej në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.
3. Mandati i komisionit është AD-HOC, vetëm për dëmet e shkaktuara nga vërshimet në disa fshatra dhe një pjesë të banuar në qytet përbri lumit Silnica.
4. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë.
5. Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim do të koordinoj punët e këtij komisioni dhe Komisionit ekzistues për vlerësim të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.




Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 8 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në propozimin e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim dt.15.01.2021, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR PLOTËSIM TË VENDIMIT

1. Me këtë vendim plotësohet vendimi 02Nr. 14/20, dt. 15.01.2021 për themelimin e komisionit për vlerësim të dëmeve nga vërshimet e datës 11. 12. Dhe 13.01.2021, si vijon:

Pas pikës 1 nënpika 1.3 shtohet nënpika 1.4 - anëtar i këtij komisioni caktohet Bajram Beqiri, Zyrtar në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit për Mbrojtje dhe Shpëtim
- Z. Bajram Beqiri
- Arkivit të Sekretarisë